

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"S'kam folur me Trump për projektin", Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet një spit al i nivelit të lartë
ADRESA	https://kohajone.com/lajme/shteti-partner-ne-investim-rama-per-situaten-ne-sazan-ushtri-te-krijuara-nga-teknologjia-ushqyen-narrativen-per-izraelin/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	11 shtator 2026, 17:37:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	11 shtator 2026, 17:50:28 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	21f03090c029f4bfa436bba97732a0228544f639393eaf4ab425e2416e439495
TEKSTI	1bb325637fd9de65067259133fd941221f620646ec8afce1b149b23974dae095
PAMJA	6867b0dea37d67025da57aefef09e0c4945922117ef38b671825d3d2834f6f52

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ac08d55c11c8c4e9deb4b628b2e536e8bc8b3671c20c86c6e3d08b949770e770
E MËPARSHMJA	a8e575be6c9df7ed163236feff40a01166cf7f0ee1105609264c644ebbfdd5f4
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac08d55c11c8c4e9deb4b628b2e536e8bc8b3671c20c86c6e3d08b949770e770>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [WEBTV](#)

- [MË TË FUNDIT](#) 

- [LAJME](#)
- [SPORTI](#)
- [EKONOMI](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [KOSOVA](#) 
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [WEBTV](#)

-  [Facebook Icon](#)
-  [Instagram Icon](#)
-  [YouTube Icon](#)

Gazeta "KOHA JONË" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

[NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA](#)

 [Swiss Digital Logo](#)

 [Koha Jone Logo](#)

[E përditshme e pavarur](#)

- [LAJME](#)
-  [EURO24 Logo](#)
- [SPORTI](#)
- [EDITORIAL](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [AKTUALITET](#)
- [EKONOMI](#)
- [KOSOVA](#)
- [RAJONI](#)
- [BOTA](#)
- [KULTURA](#)
- [TEKNOLOGJI](#)
- [SHËNDETI](#)

"S'kam folur me Trump për projektin", Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet një spital i nivelit të lartë

[Aktualitet Kryesore](#) E Premte, 11 Shtator 2026 19:50



Kryeministri Edi Rama ka folur për protestat, mundësinë e dorëheqjes dhe ndikimin e teknologjisë në krijimin e narrativave në rrjetet sociale. Në intervistën me gazetaren Rudina Xhunga, Rama tha se ndryshimi i pritshmërive të qytetarëve ka sjellë një realitet të ri në shoqërinë shqiptare, të cilin e cilësoi si "revolucion i pritshmërive të larta". **"Sa më shumë vendi ecën, aq më shumë qytetari është i prirur të thotë 'po kjo tjetra?'"**, tha Rama, duke shtuar se investimet publike shoqërohen me duartrokitje e buzëqeshje të mëdha. Ai foli edhe për deklaratën e tij se kishte menduar dorëheqjen, duke thënë se kjo lidhej me reflektimin përballë pakënaqësive dhe ndryshimit të pritshmërive të qytetarëve.

Një pjesë të intervistës, Rama ia kushtoi ndikimit të profileve jo reale në rrjetet sociale, duke iu referuar edhe debatit për projektin e investimit në Sazan dhe lidhjes së tij me Izraelin. **"Ata nuk ishin, ata nuk ekzistojnë. Ata janë të krijuar në laborator dhe i japin zë narrativave të ndryshme"**, deklaroi Rama, i cili nënvizoi se shteti shqiptar është partner në investim. Sipas tij, narrativat rreth Sazanit dhe Izraelit janë nxitur nga një "ushtri ushtarësh jo realë", të krijuar dhe zhvilluar përmes teknologjisë.

 [Koha YouTube Channel](#)

"Çfarë lidhje kishte kjo me marrëdhënien me Izraelin. Pra ishte narrativë e nxitur nga kjo ushtri ushtarësh jo realë, të rritur në laboratorët e teknologjisë", tha kryeministri. Vizita e Ivanka Trump në Vlorë disa muaj më parë, së bashku me një grup inxhinierësh, ishte një nga momentet ku u ndal kryeministri Edi Rama teksa foli për projektet turistike në Sazan dhe Zvërnec. Rama tha se nuk kishte folur kurrë me Presidentin amerikan Donald Trump për këtë projekt. Kryeministri theksoi gjithashtu se edhe ish-kryeministrat Sali Berisha dhe Fatos Nano kanë dashur të sjellin investitorë të huaj në Sazan.

 [Swiss Digital Desktop Reklama](#)

"Në Zvërnec kemi një histori tjetër, që është histori disa vjeçare. Jemi sot në pritje të një projekt-propozimi, pasi ne kemi refuzuar projektet e mëparshme. Ndërkohë që për Sazanin jemi akoma në negociata. Kjo 10 mijë dhoma, është një shifër që unë as e kam parë fare. Sazani nuk është ndonjë thesar, është zonë e minuar. Qoftë paraardhësi im dhe qoftë edhe paraardhësi i paraardhësit tim kanë dashur të sjellin investitorë në Sazan.

 [Swiss Digital Mobile Reklama](#)

Edhe unë kam dashur dy herë të tjera të sjell investitorë në Sazan, por nuk është finalizuar. Ata do bëjnë aty një destinacion eksperience. Do ketë vila, por edhe hotele të nivelit më të lartë në botë. Sheval Vlau është një firmë që s'të vjen në Shqipëri kështu. Atlantis është hoteli i famshëm në Dubai. Është Atlantis i parë që hyn në Europë. Aty do ketë edhe të tjera gjëra që lidhen me shëndetin, kalërimin. Ne jemi duke punuar për një investim të rëndësishëm shëndetësie në Vlorë", shpjegoi Rama.

Nga ana tjetër, Rama tha se në Sazan do të ndërtohet vetëm në 8% të ishullit, pra nga 560 hektarë që është ishulli, ndërtim sipas kryeministrit do të ketë vetëm në 45 hektarë. **"Sazani dhe Zvërneci janë 2 projekte të ndryshme. Të njëjtët investitorë, por dy projekte të ndryshme. Janë dy prona të ndryshme. Sazani është pronë shtetërore, Zvërneci është pronë private. Në Zvërnec po punonte kompania e cila sipas ligjit dhe bazuar në procedurën e dhënies së një leje paraprake, merr të drejtën e vendosjes së rrethimit. Në Sazan kanë nisur negociata, ishulli është 560 hektarë dhe diskutojnë vetëm për 8%. Sepse ne kemi vënë kufizime. Sipërfaqe e ndërtueshme është 8%, pra rreth 45 hektarë. Pra një hartë prone nuk është hartë ndërtimi".**

Një nga elementët e rëndësishëm të projektit do të jetë edhe ndërtimi i një spitali të nivelit të lartë. **"Në Zvërnec do të ndërtohet një spital i nivelit të lartë",** tha Rama, duke shtuar se zona do të ketë gjithashtu plazhe publike. Kryeministri theksoi se zhvillimi i zonës synon të krijojë një destinacion të ri turistik, ndërsa projekti pritet të sjellë edhe investime të rëndësishme në infrastrukturë dhe shërbim.

Lexoi edhe:

[Rama zbulon si do të zbatohet “Besa”: Pasqyra bëhet ligj](#)

[Rama: Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë kërkojnë verifikim ndërkombëtar të autorësisë, kemi kapacitete të avancuara](#)

[VIDEO/ Rrëfimi i Ramës: Kam qenë rebel, por jo i bullizuar. Më kanë dhunuar vetëm dy herë](#)

ETIKETA [edi](#) [rama](#)[ProjektSazani](#)[TrumpZvërnec](#)

SHKARKO APP

[iPhone](#)

[Android](#)

 Logo KOHA JONË SONDZH

A duhet liruar Erion Veliaj të drejtojë bashkinë nga zyra?


☐ Po

☐ Jo

Voto

Shiko rezultatin

[Më shumë nga Aktualiteti](#)



[Rama: Në Zvërnec do të ndërtohet një spital i nivelit të lartë](#)



[Rama zbulon si do të zbatohet “Besa”: Pasqyra bëhet ligj](#)



[Rama: Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë kërkojnë verifikim ndërkombë...](#)




[Patos, elektrikisti humb jetën teksa punonte në shtyllë](#)






"Prania Besnike" në Tiranë, Rama takon banorët e Shkozës



Ministri Gonxhja: Dea e Butrintit kthehet në shtëpi, pas një rrugëtim...

LAJMET E FUNDIT



"S'kam folur me Trump për projektin", Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet nj...

15 minuta më parë



Rama: Në Zvërnec do të ndërtohet një spital i nivelit të lartë

22 minuta më parë



Rama zbulon si do të zbatohet “Besa”: Pasqyra bëhet ligj

39 minuta më parë



Rama: Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë kërkojnë verifikim ndërkombëtar të autorësisë, kemi kapacitete të avancuara

44 minuta më parë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.